



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 518 Prot.

Tiranë, më datë 29.08.2025

VENDIM

Nr. 468, datë 29.08.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të Projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 29.08.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e projektit “Furnizim vendosje e-parking në kalanë e Beratit”, Brenda kufirit të Qendrës Historike Berat, me aplikues dhe zhvillues **Bashkia Berat, me rekomandimin:**
 - Pozicionimi i traut si dhe procesi i funksionimit dhe menaxhimit të tij, do të rishikohet në rast nevojë me rekomandimet e PMI Berat-Gjirokastrë;
 - Njëkohësisht me vendosjen e kufizmit të hyrjeve në Kala, të përcillet plani për të gjitha hapësirat e mundshme për parkimin e automjeteve të banorëve brenda datës 10.09.2025;
 - Të sigurohet hapësira e nevojshme e kalimit për këmbësorët e personat me aftësi të kufizuar (P.A.K), si dhe të përcillet plani i lëvizjes brenda datës 10.09.2025;
2. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI



KRYETAR
Blendi GONXHJA